ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PODUJEVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **615-24-882-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material për perde**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" INFINITT " SH.P.K.**
NUI	**601614177**
Adresa	**Dëshmorët e Kombit**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**048/168-224**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Astrit Uka**
Adresa elektronike	**infinitt.shpk@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**15.04.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me material për perde

Njoftimi per kontrate: 09.02.2024.

Afati i fundit për dorzimin e ofertav: 04.03.2024.

Data dhe ora e hapjes se ofertav: 04.03.2024. ora 13:00

Njoftimi mbi vendimin e AK: 26.03.2024.

Kriter per dhenie te kontrates: Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkesen per ri-shqyrtim te AK kemi dorezuar me 02.04.2024.

Vendimin per refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim e kemi pranuar me 04.04.2024.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qellimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 28 Specifikimet teknike
Neni 59 Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi I tendereve
Neni 60 Kriteret per dhenie te kontrates
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 19 I UOPP-se- Specifikimet Teknike

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Zyra e prokurimit prane KK Podujeve me 26.03. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar per kontrate LIRIA sh.p.k.
Kompania jone eshte eliminuar me arsyetimin se kemi ofruar moster materialin pelhure ngjyre te qelet e jo siq eshte kerkuar nga AK ngjyre e erret.
Ky arsyetim per eliminimin e ofertes sone eshte jo-ligjor dhe i palogjikshem, mostra e produktit dorezohet per tu prezentuar materiali dhe cilesia ndersa ngjyra percaktohet ne kordinim me njesine kerkuese dhe menaxherin e kontrates gjate implementimit te projektit.
Pasisqe kemi derguar kerkese per qasje me 28.03. na eshte lejuar qasja ne dokumente zyrtare nga autoriteti kontraktues.
Pas shikimit te mostrave te dorezuara nga OE LIRIA SH.P.K. konstatojme se AK ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem i cili ne baze te mostrav te dorezuara nuk ploteson specifikimet teknike per pozicionin 1 dhe 2 ne specifikacionin e tenderit ku eshte kerkuar 1. Material pelhure 400gr ndersa mostra e dorezuar nga OE eshte reth 280gr dhe per pozicionin 2 Gypa (6m) Ř 32 /2mm trashesi ndersa nga shikimi i mostrav shihet se trashesia e gypit te cilin e ka ofruar OE moster eshte 1.8mm.
Prandaj AK eshte dashur te vleresoj kete fakt dhe te eliminoje OE LIRIA sh.p.k. si i papergjegjshem duke mare parasysh dhe faktin se keto dy produkte perbejne reth 75% te vleres se projektit.
AK/Zyra e prokurimit kane shfaqur diskriminim per kompanine tone ne kete procedure tenderuese dhe ne anen tjeter favorizim per OE LIRIA SH.P.K., kompania jone eliminohet per qeshtje minore ngjyren e mostres ndersa ne anen tjeter rekomandohet per kontrate OE i cili nuk ploteson specifikimet teknike bazike dhe ka ofruar produkte te cilat nuk plotesojne specifikimet teknike minimale si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit. Keto produkte kane kosto shume me te ulet ne kete menyre pranimi i ketyre produkteve si te mireqena dhe nenshkrimi i kontrates me kete OE do te demtonte buxhetin publik perkatesisht AK KK Podujeve.
Citoj nenin 1.1 te LPP-se:

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë
AK/Zyra e prokurimit ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim mer rolin e avokatit per OE LIRIA SH.P.K. duke arsyetuar mostrat e dorezuara nen specifikimet teknike minimale ne DT
dhe deklaron se OE me ane te deklarates se specifikimeve teknike garanton se do ti liferojme
produktet ne cilesi sipas kerkesave ne DT.
Zyra e prokurimit Podujeve arsyeton mosplotesimin e spec.teknike nga OE LIRIA ndersa eliminon
oferten e kompanise sone per ngjyren e nje produkti te cilin kemi ofruar moster
qe eshte krejtesisht e palogjikshme dhe shkelje flagrante kur edhe ne kemi dorezuar deklaraten
per specifikime teknike me te cilen kemi garantuar se produktet e ofruara jane ne harmoni te plote
me spec.teknike si ne kerkesen e AK ne dosjen e tenderit.
Citoj nenin 59.4 te LPP-se
4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë
është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.
Pavarësisht nga e mëparshmja, **autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm**
nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin
material apo aspekin e tenderit ne fjalë
Qeshtja e ngjyres se pelhures eshte detaj i parendesishem i cili per ne nuk qon peshe poashtu sqarimi
eventual nga AK per qeshtjen e ngjyres nuk ndryshon kushtin material apo ndonje aspekt per tenderin
ne fjale.
AK me keto veprime ben shkelje te rende te nenit 1 dhe 6 te LPP-se duke mos trajtuar barabarte OE ofertues, theksojme faktin se produktet e ofruara nga OE Liria sh.p.k. sidomos gyp
metali nese pranohet i tille kompania jone do te mund te ofertonte me cmim 40% me te ulet qe do
te bente oferten e kompanise sone edhe me te lire se OE ne fjale.
Prandaj kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shikimit dhe krahasimit te mostrav te
dorezuara nga OE ofertues ne kete aktivitet te prokurimit, te aprovoje ankesen e kompanise
sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompanise sone i mohohet fitimi i nje kontrate publike kornize perkatesisht fitimi i pritur nga ky projekt, megjithese oferta jone ka cmimin me te ulet dhe ploteson te gjitha kriteret dhe kerkesat lidhur me specifikimet teknike te parashtruara nga AK si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit.

Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*